

**LIGJ**  
**Nr. 151/2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT  
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në paragrafët e parë dhe të tretë, të pikës 4, të nenit 4, “Niveli i taksave kombëtare”, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, fjalët “dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim” zëvendësohen me fjalët “në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 17.12.2020.